

KOMUNA DRENAS			
03.07.18			
01	030	37921	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 03.07.2018

Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit **z. Ramiz Lladrovci**

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën 27.07.2018



1. Vendim për shfuqizimin e vendimit nr.421/281 të datës 18.01.2008, në të cilën është dhënë objekti i qendrës së komunitetit në Glogoc në shfrytëzim të qendrës "Dielli"
2. Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës Komunale nr.295/12 me sipërfaqe S+053.00ha Zona kadastrale në Sankoc, për varrezat e fshatit Sankoc
3. Vendim për Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Drenasit
4. Vendim për ridestinimin e mjeteve nga mbetjet e projekteve kapitale
5. Vendim për Kornizen Afatmesme Buxhetore Komunale 2019-2021
6. Vendim për ndryshimin e Rregullores nr.12-320-19338 i datës 07.04.2017, për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Drenas,
 03.07.2018



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit(Gllogoc)

Kuvendi i Komunës
Nr. _____ dt. _____ 2018



Nga: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z.Labinot Halilaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datë: 27.06.2018.

- 1.Vendim për shfuqizimin e vendimit nr.421/281 të datës 18.01.2008, në të cilën është dhënë objekti i qendrës së komunitetit në Gllogoc në shfrytëzim qendrës Dielli.
- 2.Vendim për dhenjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës Komunale nr.295/12 me sipërfaqe S= 0.53.00ha Zona kadastrale Sankoc, për varrezat e fshatit Sankoc.
- 3.Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Drenasit.
4. Vendim për ridestininimin e mjeteve nga mbetjet e projekteve Kapitale.
- 5.Vendimi Korinza afatmesme buxhetore Komunale 2019-2021.
- 6.Vendim për Ndryshimin e rregullores nr.12-320-19338 të datës 07.04.2017, për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Drenas,
03.07.2018



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

12. Nr. 462-37732 dt. 03.07.2018



Duke u bazuar në nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2, nenit 40 paragrafi 40.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 5 shkronja h, nenit 34 pika 34.6 si dhe nenit 86 shkronja a të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt.27.06.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit NR. 421/281 të datës 18.01.2008, në të cilën është dhënë objekti i Qendrës së Komunitetit në Glllogoc në shfrytëzim Qendres Dielli

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet kthimi i Objektit Qendra e Komunitetit në Glllogoc, ngastrën kadastrale 760/2 dhe 761/1 me sipërfaqe prej 55.40 m2 në Glllogoc të dhënë mbi bartjen administrative të së drejtës shfrytëzimit të Qendrës së Komunitetit në Glllogoc.

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi nr.421-281 i datës 18.01.2008, i Kuvendit Komunal mbi bartjen administrative të së drejtës së shfrytëzimit të Qendrës së Komunitetit në Glllogoc, me bazë të cilit është lidhur marrëveshja ndërmjet Caritas Zvicër dhe Komunës së Drenasit për periudhën nëntor 2014 deri në dhjetor 2017 më të cilën vendim është dhënë Objekti i Qendrës së Komunitetit në Glllogoc në shfrytëzim Objekti Qendra Dielli në Glllogoc, ngastrën kadastrale nr.760/2 dhe 761/1 me sipërfaqe prej 55.40 m2 në Glllogoc.

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohet Caritasi Zvicran me përfaqësues Kreshnik Berisha nga Prizreni dhe Drejtoria Komunale e Arsimit.

Neni 4


Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj





REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit (Glllogocit)

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 352 - 37736 dt. 03.07. 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03L-040 të shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr.28/2008,nenit 7 dhe 10 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 35/2012 dhe nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt.27.06.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Për dhënien në shfrytëzim afat gjatë të pronës komunale të Komunës së Drenasit gjegjësisht pjesën e ngastrës kadastrale nr.295/12 me kulturë Kullosë kl.5, sipërfaqen prej $S=0.53.00$ ha, Zona kadastrale Sankoc.

Sipërfaqen e përgjithshme e dedikuar për varreza të lagjes Ajazi,Ramaj dhe Isufi Sankoc është është në sipërfaqe prej $S=0.53.00$ ha.

Neni 2

Më këtë vendim obligohet Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit që të jap pëlqim për lokacionin për varreza të fshatit Sankoc .

Neni 3


Më këtë vendim obligohet Drejtorati për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Drenasit të benë bartjen administrative të pronës dhe regjistrimin e asaj sipërfaqeje në emër të varrezave të fshatit Sankoc në librat kadastrale dhe në RDPP.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj





Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 352-37739 dt. 03.07 2018



Duke u bazuar në nenin 11,12 paragrafi 12.2 pika c ,nenin 40 paragrafi 40.2 pika a të Ligjit Nr.03/L-040 për vetëqeverisje Lokale,nenit 5 pika p nenit 34 pika 34.6 dhe nenit 82 pika c të Statutit të Komunës së Drenasit ,Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt.27.06.2018 aprovoi këtë:

RREGULLORE

PËR VARREZAT, OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT ,RREGULLIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E TYRE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË DRENASIT(GLLOGOCIT)

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në Komunën e Drenasit (Gllogocit),
2. Rregullimi, mirëmbajtja e varrezave dhe varrimi, janë veprimtari komunale të interesit publik.

Neni 2

Përkufizimet

1. Me këtë rregullore termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - 1.1. “Vend-varrezë” nënkuptojmë varrin dhe varrezat familjare.
 - 1.2. “Varr” nënkuptojmë gropën e gërmuar në tokë për të futur të vdekurin (kufomën) ose mbetjet mortore.
 - 1.3. “Varrezë” nënkuptojmë vendin/hapësirën ku varrosen të vdekurit, e cila përfshinë anën e brendshme (hapësira për të futur të vdekurin dhe hapësira tjetër përcjellëse) dhe anën e jashtme e cila përfshinë (hapësira qarkulluese, e parkimit dhe e shërbimeve tjera).
 - 1.4. “Varrmihës” nënkuptojmë punëtorin që hap varre në varreza.

- 1.5. "Varrim" nënkuptojmë ceremoninë e përcjelljes të vdekurit për në varr.
- 1.6. "Varrhumbur" nënkuptojmë humbjen e varrit, që nuk dihet se ku është varrosur.
- 1.7. "Kufomë" është trupi i njeriut, i privuar nga funksionet jetësore.
- 1.8. "Shërbim i varrimit" është veprimtaria që zhvillohet nga subjektet publike ose private, nga çasti i vdekjes deri në varrimin e kufomës.
- 1.9. "Zhvarrim" është nxjerrja e kufomës dhe/ose mbetjeve mortore nga varri.
- 1.10. "Zhvarrim i zakonshëm" është zhvarrimi që kryhet pas përfundimit të kohës së prehjes.
- 1.11. "MAPL" është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- 1.12. "DSHPE" është Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
- 1.13. "Ekshumimi" -zhvarrosje, nxjerrja e kufomës nga varri.
- 1.14. "Zhvarrim i jashtëzakonshëm" është zhvarrimi që kryhet para përfundimit të kohës së prehjes, sipas procedurave ligjore, për ekspertizë kriminalistike, për arsye transferimi në një varr tjetër, pas një periudhe të paracaktuar kohe ose për interes publik.
- 1.15. "Kohë e prehjes" është koha gjatë së cilës nuk lejohet zhvarrimi i zakonshëm i kufomës.

Neni 3 Varrezat

1. Në aspektin e hapësirës dallojmë këto varreza:
 - 1.1. varreza të vogla (deri në 5 ha).
 - 1.2. varreza të mesme (prej 5 deri në 20 ha) dhe
 - 1.3. varreza të mëdha (mbi 20 ha).
2. Hapësirat e përcaktuar për varreza duhet të jenë të parapara me planet Urbanistike, ose me plan të veçantë në pajtim me planet urbanistike.
3. Varrezat duhet t'i përmbushin nevojat për varrosjen e të vdekurve në një vendbanim (fshat), disa vendbanime dhe brenda lagjeve lokale në qytet.
4. Lokacioni apo vendi i varrezave e caktohet me vendim të Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Neni 4

1. Ndërtimi i varrezave të reja dhe zgjerimi i varrezave ekzistuese përcaktohet me plan dhe programin për marrjen e masave për rregullimin e gjendjes në hapësirë.
2. Plan i dhe programi përfshinë periudhën se paku 100 vjet për varreza të reja, kurse për zgjerimin e varrezave ekzistuese më së paku 30 vjet me mundësi të zgjerimit në etapa.

3. Varrezat ekzistuese mund të zgjerohen, nëse për to ekziston hapësira e paraparë me planin zhvillimor të komunës dhe nëse janë të siguruara edhe kushtet tjera të parapara me këtë rregullore dhe me ligjet në fuqi .

Neni 5

1. Sipas mënyrës së themelimit, respektivisht mënyrës së vdekjes, varrezat klasifikohen në të përgjithshme (publike) sipas përkatësis fetare dhe të veçanta.
2. Në varreza të veçanta hyjnë: varret me përmendore, varret ushtarake, varret e heronjve dhe dëshmorëve, varret anonime, varret masovike prej fatkeqësive natyrore .

Neni 6

1. Sipërfaqja e nevojshme neto për varr duhet të jetë 2. 20 metra katror për banor.
2. Te përcaktimi i sipërfaqes për varr, duhet llogaritur bruto dhe neto sipërfaqen e varrit.
3. Sipërfaqja neto e varrit, përfshinë parcelën/vendin e varrit.
4. Sipërfaqja bruto e varrit, përfshin neto sipërfaqen e varrit të rritur edhe për distancën në mes varreve.

Neni 7

1. Varrezat duhet vendosur në një vend me sipërfaqe të mjaftueshme, i përshtatshëm sipas konfiguracionit dhe kushteve të lokacionit për varrosje.
2. Vendi i varrezave duhet të jenë jashtë vendbanimit ose afër vendbanimit me qasje në rrugë dykrahëshe dhe me shtegun (rrugicë e ngushtë) e ndarë për këmbësorë.
3. Hapësira për varreza duhet t'i përmbush këto kritere:
 - 3.1 Sipas pozitës së varrezave toka duhet të jetë e kulluar, me rreze dhe e qetë të jenë larg rrjedhave nëntokësore dhe sipërfaqësore të ujërave, dhe jashtë këtyre zonave: zonave të ujërave të mbrojtura, zonave të cilat vërshohen nga ujërat, zonave të mbrojtura të trashëgimisë natyrore dhe rajoneve malore.
 - 3.2 Varrezat e reja duhet të jenë së paku 50 m nga rruga automobilistike respektivisht qendra të ndërtuara ose që do të ndërtohen, ndërtesa të dedikuara për çështje afariste.
 - 3.3 Tek zgjerimi i varrezave ekzistuese, largësia duke pasur parasysh pikën 3 të nenit 7, mund të jetë deri në 10 m me kusht që për gjatë varrezave të sigurohet një shirit gjelbërues në gjerësi minimale prej 5 m i cili e përshkon tërë gjatësinë e objekteve kontaktuese.

Neni 8

1. Varrezat përbëhen prej:
 - 1.1 Vendit të varrit (vetë varri) .
 - 1.2 Radhët e varrezave të cilën e përbëjnë një mori varresh (varret) .
 - 1.3 Fushat e varrezave (disa rende të varreve por jo më tepër se 200 varre në një shteg) .
 - 1.4 Shtegu i cili lidh grupet e varreve me fushën e varreve ose rendin e varreve .
 - 1.5 Shtigjet kryesorë të cilat lidhin fushat e varreve, me pushimore dhe hapësirën për zgjerim.
 - 1.6 Rrugëve interne dhe eksterne (jashtme) për qarkullimin e automjeteve dhe parkimin .
 - 1.7 Gjelbërimet (grupore dhe përcjellëse) .
 - 1.8 Vendi ku bëhet përshëndetja e fundit lamtumirës, mund të jetë i mbyllur ose i hapur në përputhje me rregullat sipas përkatësisë fetare.
 - 1.9 Objektet tjera përcjellëse shërbyese për kufomën (hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare).
 - 1.10 Parkingu për automjete .

Neni 9

1. Varri është gropa e varrit me proporcion sipas normave urbanistike:
 - 1.1. 1.00 x 0.60 m – deri në moshën 3 vjet.
 - 1.2. 1.50 x 0.60 m – 1.50 x 0.75 m prej moshës 4 vjet deri në moshën 10 vjet.
 - 1.3. 2.10 x 0.70 m – 2.50 x 1.20 m mbi 11 vjet.
2. Fundi i gropës së varrit sipas grupeve të përcaktuara në paragrafin 9.1 të kësaj rregulloreje, duhet të jetë më së paku 50 cm mbi nivelin e pikës më të lartë të ujërave nëntokësore.
3. Thellësia e varrit përcaktohet në bazë të rregullave sipas riteve fetare e që nuk mund të jetë më e thellë se 180 cm.
4. Dimensionet e varrezave familjare janë 2.40 x 2.80 m, maksimalisht 4 varreza.
5. Mbulesa e varrit mbi kufomë, duhet të bëhet sipas riteve fetare, por jo më shumë se 0.8 m.
6. Lartësia e varrezave familjare dhe e përmendoreve mund të jetë më shumti deri në 2 m. Në to mund të shënohen atributet e personit të vdekur (emri, mbiemri, viti i lindjes dhe i vdekjes).

Neni 10

1. Varri mund të bëhet edhe me mur prej betoni ose prej materiali tjetër.
2. Varrezat duhet të jenë të renditura në atë mënyrë që rendet e varrezave të mos të jenë më të gjata se 60 m.

3. Fushat e varrezave përbëhen prej rendeve të varrezave dhe distancës ndërmjet tyre që shërben si shteg për me shkuar deri te varri.
4. Fushat e varrezave duhet të jenë të ndara me shtigje kryesore me gjatësi minimale prej 3 m.
5. Shtigjet duhet të jenë të ndërtuara prej materialit të fortë pa pengesa për lëvizje dhe jo më të pjerrtë se 8% ndërsa tërthorazi jo më pjerrtë se 1% .

Neni 11

Me rastin e varrosjes, duhet të mbahet evidenca nga ana e organit kompetent (DSHPE-së) respektivisht ndërmarrja publike ose ndërmarrjes tjetër e specializuar për këtë çështje të autorizuar .

Neni 12

1. Në pajtim me nenin 8 pika (9) të kësaj rregullore, objektet tjera përcjellëse shërbyese duhet të kenë hapësirën për pastrim, qëndrim deri në varrosje, kroi i ujit, ndriçimi dhe pajisje tjera të nevojshme sanitare), mund të jetë: me shufra metalike me bazament ose material tjetër bashkëkohor, ndërtohen në bazë të një plani të veçantë në pajtim me planin e përgjithshëm të varrezave.
2. Hapësira për qëndrimin e kufomës duhet të jetë e ndërtuar me norma teknike.
3. Parkingu i automjeteve, duhet të jetë jashtë varrezave dhe i ndarë nga rruga publike.
4. Rrugët e këmbësorëve – shtigjet rregullohen si trotuare të pavarura për qasje deri te vend varrimi dhe të përshtatshme për kalim për personat me karrocë (hendikep) .

Neni 13

Mirëmbajtja e varrezave

1. Organi kompetent i administratës (Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë), administron me shërbimin e varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në qytet dhe fshatra, nëse ndryshe nuk është e rregulluar me ligj.
2. Të gjitha varret dhe varrezat do të trajtohen me ndershmëri dhe dinjitet nga komuna.
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, të gjithë banoret do të kenë qasje të barabartë në ofrimin e shërbimeve komunale sipas kushteve të parapara me këtë rregullore.

Mjetet e nevojshme për Shërbimet e varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave

Neni 14

1. Shërbimet e varrimit, rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave në territorin e Komunës i kryen ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar për këtë qëllim.
2. Shërbimet fetare i kryen bashkësia fetare.

Neni 15

1. Punët në vështirim të nenit 14 (pika 1) e kësaj rregulloreje rregullohen me kontratë administrative në pajtim me rregullat për prokurimin publik dhe shërbimeve publike.
2. Shpenzimet për shërbime të varrimit kryhen nga Komuna, nga kategoria (mallra dhe shërbime) e buxhetit të komunës, për të gjithë banorët e komunës së Drenasit .
3. Me leje të DSHPE-së, rregullimin e varrit mund ta bëj edhe anëtar i familjes së të vdekurit .

Neni 16

1. Mirëmbajtja e varrezave, në vështirim të kësaj rregulloreje përfshinë: objektet tjera përcjellëse shërbyese (hapësira për qëndrim të kufomës), ndriçimin publik, rrugët kalimtare, shtigjet, kroin për ujë, rrethojën e varrezave, parkingun e automjeteve, stabilimentet sanitare, gjelbërimin, pastërtinë dhe rendin në varreza.
2. Mirëmbajtja (disa punë zejtare) në varr dhe varreza familjare mund të bëhen nga ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar për këtë çështje, përjashtimisht edhe nga vetë familjarët e të vdekurit në këto kushte:
 - 2.1. Të merret leja nga ana organit kompetent (DSHPE-së) ose ndërmarrja publike e autorizuar.
 - 2.2. Koha e kryerjes së punëve duhet të jetë prej orës 7 – 18:00 në ditët e punës.
 - 2.3. Materiali ndërtimor (rëra, zhavorri, hekuri dhe materiali tjetër) lejohet të qëndrojë në varreza për kohë të shkurtër në mënyrë që të mos pengoj lëvizjen e vizitorëve në varreza dhe pas kryerjes së punëve duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme.
 - 2.4. Transporti i materialit, duhet të bëhet vetëm nëpër rrugë dhe shtigje që i cakton dhënësi i lejes.
 - 2.5. Gjatë punimeve nëse haset në ndonjë pjesë të arkivolit ose ndonjë ashtë (kockë) duhet të mbulohen në të njëjtin vend.
 - 2.6. Nëse gjatë punimeve gjinden sende me vlerë duhen t' i dorëzohen Organit kompetent (DSHPE-së).
 - 2.7. Kroi, gjatë përdorimit duhet të përdoret me kujdes që mos t'ju shkaktohet dëmi varreve dhe varrezave tjera
 - 2.8. Për vendosjen e pllakave përkujtimore ose përmendoreve, duhet të paraqitet kërkesë e veçantë me skicën e objektit, respektivisht përmendores dhe vërtetimin se është siguruar shfrytëzimi i vendvarrimit.

3. Shpenzimet lidhur me kryerjen e punëve sipas paragrafit 2 të këtij neni bien në barrë të atij i cili bënë kërkesën për mirëmbajtje të varrit dhe varrezave familjare.

Neni 17

1. Planin e mirëmbajtjes së varrezave, kushtet dhe tarifat i cakton DSHPE-ja.
2. Për tarifa nxirret vendim i veçantë nga ana e Kuvendit të Komunës – apo me rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba me propozim të DSHPE-së.

Neni 18

Vizitat në varreza

1. Vizituesit e varrezave janë të detyruar që në varreza të sillen me dinjitet në vendet ku ato prehen.
2. Varrezat mund të vizitohen në çdo kohë, përpos nëse vendoset orar i veçantë.
3. Në varreza nuk mund të vijnë fëmijët deri në moshën 10 vjeçare, përjashtimisht me përcjelljen e prindërve, personave tjerë të moshuar ose kujdestarit të tij.

Neni 19

1. Në varreza ndalohe:

- 1.1. Shkatërrimi me qëllim i vendvarrimeve.
- 1.2. Shkelja dhe kapërcimi nëpër varre dhe varreza dhe shlyerja tyre.
- 1.3. Shkaktimi dëmit në varreza ose në shenjat tjera përkujtimore (në përmendore dhe objekte tjera përkujtimore në varreza).
- 1.4. Prishja e rendit në varreza.
- 1.5. Thyerja e rrethojave në varreza, dëmtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, drunjtëve dhe bimëve tjera të mbjellura në varreza.
- 1.6. Hyrja në hapësirën e varrezave me automjete dhe mjete tjera tërheqëse pa pëlqim paraprak ;
- 1.7. Lëshimi i bagëtive në varreza.
- 1.8. Krijimi i papastërtisë në shtigjet dhe në sipërfaqet e gjelbëruara, vërja ose hedhja e kurorave të vyshkura, luleve të vyshkura ose sendeve tjera.
- 1.9. Fotografimi pa leje i varrezave për çështje profesionale.
- 1.10. Sjellja dhe lërja pa leje e sendeve të ndryshme në varre dhe varreza që nuk kanë të bëjnë me varre dhe varreza.

- 1.11. Hyrja në objektin ku qëndron kufoma dhe objektet tjera jashtë kohës së përcaktuar për varrim;
- 1.12. Ndezja e qirinjve jashtë shtëpizave të parapara në varreza.
- 1.13. Qëndrimi i lypsarëve brenda dhe në hyrje të varrezave.
- 1.14. Hedhja e mbeturinave brenda në varreza dhe jashtë varrezave.
- 1.15. Zjarrvënja e qëllimshme brenda varrezave.

Neni 20

DSHPE-ja cakton rregullat e sjelljes në pajtim me nenin 17 të kësaj rregulloreje dhe duhet publikuar në vend të dukshëm në hyrje të varrezave.

Neni 21

Varrimi dhe veprimet tjera lidhur me varrimin

1. Varrimi bëhet në pajtim me dispozitat sanitare edhe sipas mënyrës që i përgjigjet pietetit ndaj të vdekurit, në saxe të nderimit të ndjenjave të farefisit dhe të personave tjerë të cilët kanë qenë në afërsi me të vdekurin.
2. Varrimi duhet të bëhet vetëm pasi të jetë vërtetuar vdekja në mënyrë të caktuar me dispozita të veçanta.
3. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet pas konstatimit të personit të autorizuar- Mjekut.
4. Varrimi i të vdekurit mund të bëhet edhe në varrezat të cilat i ka caktuar i vdekuri për së gjalli, ose në varrezat që i zgjedhë familja e tij ose personat të cilët kujdesen për varrosjen e tij.

Neni 22

Lejen për varrimin e të vdekurit në varrezat e caktuara dhe për vendvarrim në qytet dhe fshat e jep DSHPE-ja, respektivisht ndërmarrja publike ose ndërmarrja tjetër e specializuar e autorizuar, si dhe në koordinim me zyrën e gjendjes civile në komunë (te konsultohet Ligji për gjendje civile),

Neni 23

1. Bartja (transporti) i kufomave behët me automjete të veçanta që i plotësojnë kriteret për këtë veprimtari.
2. Deri në aktin e varrosjes kufomat duhet të ruhen në lokale të caktuara për këtë qëllim.
3. Bartja e kufomave deri të varrezat bëhet sipas rregullave të riteve fetare të komuniteteve.

Neni 24

Bartjen e kufomave në territorin e komunës e bënë ndërmarrja publike e specializuar komunale ose ndërmarrja tjetër e specializuar e kontraktuar për këtë qëllim apo nga ana e vetë familjarëve.

Neni 25

Para varrimit, kufomat e personave të merituar, heronjve dhe dëshmorëve dhe personave tjerë me merita të veçanta, mund të ekspozohet në vendin e caktuar jashtë varrezave me qëllim të dhënies së nderimit të veçantë të pasvdekjes, nëse organizimi i vdekjes bëhet nga organet komunale ose organet qendrore të shtetit.

Neni 26

1. Nëse veprimtaria e varrimit organizohet nga ndërmarrja publike lokale ose ndërmarrja tjetër publike e specializuar, është e detyruar që për varrimin e të vdekurve të sigurojë shërbimin e përditshëm, duke përfshirë edhe të dielat dhe festat shtetërore siç vijon:
 - 1.1. Prej 1 majit deri me 30 shtator prej orës 8 deri në orën 18:00 më së voni deri në ora 20:00;
 - 1.2. Prej 1 tetorit deri më 30 prill prej orës 8 deri në ora 16:00, më së voni deri në ora 18:00.
2. Veprimtaria e varrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, rregullohet me anë të kontratës në mes të komunës dhe ndërmarrjes publike lokale të specializuar ose ndërmarrjes tjetër të specializuar për këtë qëllim.

Neni 27

Dhënia e nderimit të fundit të (pasvdekjes) mund të bëhet në hapësirën e përcaktuar në vend-varreza.

Neni 28

1. Me lejen e organit kompetent komunal (DSHPE-së) ,inspeksionit sanitar, dhe personit tjetër të autorizuar , mund të bëhet zhvarrosja (nxjenja) e mbetjeve të kufomës për t'u bartur – rivarrosur në një vend-varrezë tjetër ose për çështje tjera (ekshumacionin e kufomave).
2. Lidhur me pikën 1 të këtij neni mbahet procesverbali nga ana e organit kompetent (DSHPE-së) ose personit tjetër të autorizuar për këtë çështje dhe i nënshkruar nga palët.
3. Shpenzimet lidhur me punën rreth zhvendosjes dhe çështjeve tjera (ekshumacionin e kufomave) bien në barrë të vetë atij i cili ka kërkuar zhvendosjen e mbetjeve të kufomës ose për çështje tjera (ekshumacionin) .

Neni 29

Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bënë organi kompetent për çështje të shërbimeve komunale (DSHP-ja) si dhe inspeksioni (përkatës).
2. Inspeksioni gjatë mbikëqyrjes mund të marr masa dhe të urdhërojë marrjen ose mos marrjen e një veprimi të caktuar në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e aplikueshme të ligjit;
3. Në vendimin e inspeksionit mund të ushtrohet ankesa në afatën prej 30 ditësh nga dita e njoftimit, drejtuar Kryetarit të Komunës.

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 30

1. Për shkelje te nenit 16 paragrafi 2, nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafët , 1.1 – 1.15 dënohen për kundërvajtje me gjobë:
 - 1.1.Personi fizik në shumën prej 20€-200€;
 - 1.2.Personi i biznesit individual prej 50€-400€;
 - 1.3.Personi përgjegjës i personit juridik prej 50€-400€
 - 1.4.Personi juridik prej 50€- 400€.



DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 31.

Çdo dispozitë e kësaj rregulloreje që bie ndesh me ligjet në fuqi epërsi do të kenë dispozita ligjore.

Neni 32.

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita e protokollimit në MAPL dhe publikimit në Web-faqën e Komunës.

 
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

12 Nr. 400-36371 dt. 29.06. 2018



Në bazë të nenit 11, 12 dhe 40.40.2 nën b dhe c të ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të nenit 8 të ligjit për Financat e Pushtetit Lokal 03/L-049 si dhe nenit 34.6 nën b dhe c të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 27.06. 2018, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR RIDESTINIM TË MJETEVE

Neni 1.

Më këtë vendim, miratohet ridestnimi i mjeteve për shpenzime kapitale në programin buxhetor Drejtorati për Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 2.

Ridestnimi i mjeteve bëhet nga këto projekte kapitale me këto shuma :

1. Kanalizimi i Ujrave të zeza në Kishnarek më kod të projektit **89075 (10)** në shumë prej: 4,318.50 €
 2. Kanalizimi i ujrave të zeza në Fshatin Sankoc më kod të projektit **89072 (10)** në shumë prej: 4,077.00 €
 3. Ndertimi i kanalizimit në fshatin Abri më kod të projektit **43020 (10)** në shumë prej: 3,005.80 €
 4. Kanalizimi i ujrave të zeza në Komoran- Lagja e Re më kod të projektit **46116 (10)** në shumë prej: 1,438.40 €
 5. Kanalizimi i ujrave të zeza në Fshatin Arllat më kod të projektit **46117 (10)** në shumë prej: 9,294.00 €
 6. Kanalizimi i ujrave të zeza Terdec me kod të projektit **46121 (21)** dhe shumë prej: 915.00 €
 7. Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Llapushnik me kod projekti **46148 (21)** dhe shumë prej: 8,320.00 €
 8. Asfaltimi i rrugës në fshatin qikatov e vjeter me kod të projektit **44748 (22)** dhe shumë prej: 15,493.00 €
- Në shumë prej : 46,861.70 €**

Neni 3.

Ridestnimi i mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi ridestnohen në këto projektet kapitale:


1. Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Negroc më kod projekti **46124 (10)** dhe në shumë prej : 17,614.00 €
2. Kanalizimi i ujrave të zeza Nekoc me kod projekti **46123 (10)** në shumë prej: 13,754.70 €
3. Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec me kod të projektit **44745 (10)** në shumë prej: 15,493.00 €

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Glllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 400-36375 dt 29.06, 2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2, neni 40 paragrafit 40.2 të ligjit nr. 03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës të Drenasit ne mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën: 27.06.2018 miratoj këtë:

VENDIM

Neni 1.

Më këtë vendim aprovohet korniza afatmesme buxhetore për vitin 2019-2021.

Neni 2.


Pjesë e këtij vendimi është korniza afatmesme buxhetore 2019-2021, si dhe lista e projekteve kapitale.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës

Neni 4.


Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA E DRENASIT			
QEVERISJE KOMUNALE			
Data:		29.06.2018	
Nj. Cakt.	Drejt.	Shifra	Vendi
12	400	36975	

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE
2019 - 2021

Drenas, qershor 2018

PËRMBAJTJA

I. HYRJE

II. STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE - DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME

III. KORNIZA FISKALE

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2019-2021

3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministrinë e Linjës dhe Financimi i Jashtëm

3.4 Politikatat e reja

3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2019-2021

3.6. Analiza Gjimore

IV. KORNIZA E PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE


V. INFORMACIONET SIPAS PROGRAMEVE

I. HYRJE

Korniza Afatmesme Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshëm për të arritur objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2019-01 të lëshuar nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2019-2021. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e nëposhtme:



II. DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME 2019-2021 NGA STRATEGJIA ZHILLIOMORE KOMUNALE

Komuna e Drenasit gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, në një sipërfaqe prej: 275.6 km². Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Drenasit ka gjithsej 42 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna ka 58,451 banorë të organizuar në 8,816 ekonomi familjare .

Mbi 2120 biznese operojnë brenda komunës. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Drenasit, afërsisht gjysma e tyre merren me veprimtari tregtare, 42% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 4.0% në prodhimtari, pjesa tjetër në transport.

Administrata e Komunës së Drenasit është e organizuar përreth zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit. Nga të cilat pesë janë të vendosura në fshatra .

Vizioni i mëposhtëm për Komunën i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna siç janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2019 (I) të lëshuar nga Ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Drenasit është të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributev binjake prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Katër nga këto prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave jashtë, ndërsa një prej tyre është i brendshëm dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Drenasit:

1. FORCIMI I EKONOMISË KOMUNALE ME MUNDËSI PËR TË GJITHË

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimit të standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë

2. PËRMIRËSIMI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SË QYTETARËVE

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive

3. PËRMIRËSIMI I AMBIENTIT TË KOMUNËS DHE QËNDRUESHMËRIA E TIJ

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimit dhe rigjenerimit të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimit të standardeve ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

4. KRIJIMI I QEVERISË KOMUNALE QË OFRON SHËRBIME EFIKASE DHE QË U PËRGJIGJET KËRKESAVE TË QYTETARËVE

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

- ◆ Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve.

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2019-2021 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

III. KORNIZA FISKALE KOMUNALE

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore), mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2019-2021 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, Konsumi dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2019 - 2021 parashihet një rritje reale vjetore mesatarisht 5%.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të zbutet, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative.** Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve) si dhe kanë mundësinë e huamarrjës sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Drenasit në periudhën afatmesme buxhetore 2019-2021 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal

Rejstrimi	2018 (6411)(6.2)	2019 (6411)(6.2)	2020 (6411)(6.2)	2021 (6411)(6.2)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV	4.6 %	4.9 %	5.1 %	5.3 %
Konsumi	4.1 %	3.7 %	3.6 %	3.8 %
BPV për kokë banori	4.2 %	4.5 %	4.7 %	4.9 %
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	61,132	61,515	61,898	62,281
Numri i bizneseve të regjistruara	2,570	2,795	3,020	3,245
Numri i nxënësve	13,138	13,150	13,175	13,195

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2019-2021 dhe drejtoratet komunale.


3.2. TË HYRAT KOMUNALE DHE PARASHIKIMI AFAT-MESËM 2019-2021

Të hyrat e Komunës së Drenasit nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Tabela 2: Buxheti Total i Komunës në vite , shprehur në Euro:

Të hyrat sipas sektorve	Aktuali 2018	2019	Projeksioni 2020	2021
Spektori i Administratës	5,750,213	6,640,566	7,160,797	7,576,357
Spektori i Arsimit	6,916,016	6,602,633	6,618,631	6,650,541
Spektori i Shendetësisë	1,811,070	1,928,404	1,877,727	1,971,913
Gjithsej të hyrat:	14,477,299	15,171,603	15,657,155	16,198,811

Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2019, të hyrat buxhetore për Komunën, si tërësi do të shënojnë rritje graduale. Rritja e të hyrave buxhetore do të jetë mesatarisht **4.80%** në krahasim me vitin 2018. Sipas të dhënave të prezantuar në tabelën më poshtë, kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me KASH-in 2019-2021. Rritja kryesisht është reflektuar në Grantin e Përgjithshëm dhe të Shendetësisë të Komunës .



Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, kanë shënuar rritje të ndjeshme nga viti në vit po ashtu. Të hyrat vetanake të planifikuara rriten përafërsisht **12.59%**, krahasuar vitin 2019 me 2018. Kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyrat e vetme tatimore, nga Tatimi në Pronë, ku norma tatimore për vitet 2019-2021 nuk ka rritje në bazë të legjislacionit në fuqi, duke llogaritur gjithçka tjetër njëjtë. Realisht nëse shikojmë planifikimin nga viti 2019 deri në vitin 2021 rritja e të hyrave të planifikuara nga Tatimi në Pronë do të jetë për **3.17%**.

KALKULIMET E TATIMIT NË PRONË:

- *Vlera e Patundshmërisë* – sipas ndarjes së pronave në kategori të zonave
- *Vlera e Kalkuluar Vjetore*- që duhet të mblihdhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj)
- *Norma e Pagesës Vjetore*- Pagesat për vit, duke përjashtuar pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë, si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar
- *Borxhi i Akumuluar dhe Pagesa e Pritur e Borxhit*
- *Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore*

KALKULIMET E TË HYRAVE TJERA:

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të Komunave janë të hyra jo-tatimore (kryesisht taksa dhe ngarkesa tjera)
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit komunal.
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumin e shërbimeve të ofruara

Tabela 3: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2019-2021, shprehur në Euro

	Komuna: Glllogoc	Grantet dhe THV – 2018 (këtë vit)	Grantet dhe THV – 2019 (vitin e 1)	Grantet dhe THV – 2020 (vitin e 2)	Grantet dhe THV - 202010 (vitin e 3)
		në Euro	në Euro	në Euro	në Euro
	BURIMET E TË ARDHURAVE				
0.	GRANTET	13,146,522	13,701,842	14,298,325	14,794,687
	Granti i Përgjithshëm	4,638,537	5,384,031	5,861,967	6,235,233
	Granti i Arsimit	6,861,389	6,561,881	6,592,631	6,623,541
	Granti i Shëndetësisë	1,646,596	1,755,930	1,843,727	1,935,913
	I-A. Huamarrja.....	164,101	156,226		
1.	Të hyrat nga Lejet e Operimit	110,000	120,000	125,000	130,000
	Funksionimet e subjekteve ekonomike brenda teritorit të Komunës.	110,000	120,000	125,000	130,000
2.	Shfrytëzimi i Tokës dhe Lejet e Ndërtimit	70,000	80,000	85,000	95,000
	Lejet për ndërtim dhe konstruktive	70,000	80,000	85,000	95,000
3.	Inspektimi i tokës dhe aktivitetet Gjeodezike	65,000	75,000	80,000	85,000
	Përgatitja e plan.urban.dhe inspekt.që kanë të bëjë me dimensionet e pronës	25,000	30,000	30,000	30,000
	Aktivitetet në teren që kanë të bëjë me matjen e vendit	40,000	45,000	50,000	55,000
4.	Shërbimet e inspektimit të Shëndetit dhe Sigurisë	10,000	15,000	20,000	24,000
	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik	5,000	7,000	10,000	12,000
	Inspektimi i ambientit	2,500	3,500	4,000	5,000
	Inspektimi i ndërtimit,shërbimit të zjarrfikësve dhe konstruktimit	2,500	4,500	6,000	7,000
5.	Shfrytëzimi i pronës Komunale	86,000	96,000	99,000	101,000
	Baza ditore apo bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale apo jo komerciale	86,000	96,000	99,000	101,000
6.	Pagesat në lidhje me Automjetet	90,000	95,000	97,000	99,000
	Lejet e automjeteve	5,000	5,000	5,000	5,000
	Parkimi në parkingun publik i paisur me garazhim apo hapsira tjera	5,000	5,000	5,000	5,000
	Regjistrimi i automjeteve	80,000	85,000	87,000	89,000
7.	Çertifikatat dhe Dokumentet Zyrtare	65,000	75,000	80,000	82,000
	Dokum.lidhur me statusin shoqëror	60,000	70,000	75,000	80,000

	si dhe të lindjes, vdekjes, martesës, shkëmbimit				
	Të tjera	5,000	5,000	5,000	2,000
8	Tatimi në Pronë	400,000	410,000	415,000	423,000
	Pagesat e tatimit në pronë	400,000	410,000	415,000	423,000
9	Të ardhurat tjera	5,676	15,535	17,830	20,124
	Pagesat tjera				
I-A.	Nëntotali I-A , Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat)	901,676	981,535	1,018,830	1,059,124
	Denimet në komunikacion, të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)	150,000	180,000	184,000	185,000
	Gjyba të gjykatave	60,000	95,000	96,000	97,000
I-B.	Nëntotali I-B , Të ardhurat indirekte (Pjesa që i takon komunave)	210,000	275,000	280,000	282,000
I	Totali i Administratës komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	1,111,676	1,256,535	1,298,830	1,341,124
	TË ARDHURAT NGA ARSIMI	24,000	25,000	26,000	27,000
	Qerdhet	24,000	25,000	26,000	27,000
	Mësimi joformal	-	-	-	-
II	Totali – Arsimi	24,000	25,000	26,000	27,000
	TË ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA	31,000	32,000	34,000	36,000
1	Shëndetësia primare	30,000	31,000	32,000	33,000
2	Të tjera	1,000	1,000	2,000	3,000
III.	Totali - Shëndetësia	31,000	32,000	34,000	36,000
Ko di 21	TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNË S (I+II+III):	1,166,676	1,313,535	1,358,830	1,404,124
	TOTALI I TË HYRAVE KOMUNALE	14,477,299	15,171,603	15,657,155	16,198,811

Komuna vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme (2019-2021) do të përbëjnë afërsisht 90.99% të buxhetit total të komunës, edhe pse në vitet paraprake pjesëmarrja e granteve në buxhet ka qenë përafërsisht 92%.

3.2.1. Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët

Vlera totale e projekteve me bashëfinancim me Ministritë e Linjës dhe Donatorët tjer 2019-2021 është në shumë prej: 1.850,000 Eur.

Tabela 4: Projektet me bashkëfinancim

Emri	Partneri Bashkëfinancues	Gjithsej euro:		Prokurim i nga:	Komente	Opsionale	
		Komuna	Bashkëfinancuesi			% përfitues meshkuj	% përfitues femra
Ndertimi i Stadionit (Faza e dytë)	MKRS	350,000	1,500,000	Komuna		50.87	49.13
Totali		350,000	1,500,000			50.87	49.13

3.2.2. Politikat e reja

Komuna e Drenasit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2019-2021, sygjerimet e Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10.00%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë Qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2019 dhe 2021 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunën e Drenasit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference-negative që do të shkaktonte ulja e nivelit të Grantit të Përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetore të ndarjes së Grantit të Arsimit për Komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë Grantin e Arsimit, duhet pas parasysh se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. **Komuna nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.**

Së treti, Komuna ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga për shërbyesit civil të Kosovës, ndonëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e komunës. Tutje, komuna nuk posedon me informatat e nevojshme për të bërë këtë analizë, të cilën në të ardhmën ndoshta do ta ofronte Ministria e Administratës Publike.

Së katërti, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunë, është edhe politika që do të zgjedhet nga viti 2019 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Drenasit aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të

bëhet për financimin e kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërime nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politikave.

Së pesti, Komuna ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Qëndrore, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveq se nga të Hyrat Vetanake Komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht **eliminimit të atyre taksave e ngarkesa komunale** që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente dhe fer, karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.

Tutje, Komuna e Drenasit, është ballafaquar gjatë dy viteve të fundit me rënien e dukshme të të hyrave nga ngarkesa e bizneseve si rezultat i lirimt të bizneseve nga ky obligim që po e bëjnë disa komuna të Kosovës. Qeveria Komunale në 3 vitet e ardhëshme planifikon të analizojë tutje trendin e të hyrave nga kjo fushë, rrjedhimisht në bazë të analizës të propozojë modifikim të vendimit të Asamblesë Komunale, eventualisht propozim të masave shtesë drejt evitimit të çështjeve të dala drejt administrimit të këtij vendimi të marrë nga Asambleja Komunale.

3.3.SHPENZIMET KOMUNALE DHE PARASHIKIMI I TYRE AFAT-MESËM 2019-2021(VITIN E 1-VITIN E 3)

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore komunale 2019/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2019, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditi. Si rezultat Komuna e Drenasit prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive ekonomike të shpenzimeve buxhetore:

Tabelat e kërkesave sipas programeve dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve, shprehur në Euro -€:

Tabela 5: Kërkesat buxhetore për vitin 2019

Programi	Programi Mili	Mëditi Shërbime	Shërbime komunale	Shërbime në	Shërbime në	Gjithsej
D.Administratë	273,361	132,120	1,500	5,000	77,000	488,981
D.Gjeod, Kad.Pr	72,074	4,610			50,000	126,684
D.Buxh.dhe Fin.	97,587	14,550				112,137
D.Bujq.Zhvill.Rur	67,776	10,700		50,000		128,476
D.Arsim	6,118,191	537,840	85,493	100,000	492,206	7,333,730
D.Shëndetësi	1,281,838	340,590	44,400	76,347	340,000	2,083,175
Shërb.Sociale	93,886	15,680	5,720		15,000	130,286
D.Urban.Pl.Haps.	53,119	17,450			72,000	142,569
D.Kult,Rini,Sport	72,278	47,320		125,000	200,000	444,598
D.Shërb.Publike	181,387	207,550	52,000	10,000	293,406	744,343
D.Inspeksion	58,661	31,100				89,761
Z.Kryetarit	127,840	42,600		15,000		185,440
Z.Kuvendi	108,920	23,100				132,020
Z.Komunitete	8,282	1,660				9,942
D.Zhvillim Ekono.	45,052	7,700				52,752
D.Infrastrukturë	49,259	17,450			2,900,000	2,966,709
Gjithsej:	8,709,511	1,452,020	189,113	381,347	4,439,612	15,171,603


Tabela 6: Kërkesat buxhetore për vitin 2020

Programet	Paga dhe Mëq.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Ko- munale	Subvenci- one	Sh.Kapital- e	Gjithsej
D.Administratë	274,728	132,120	1,500	5,000	51,000	464,384
D.Gjeod, Kad.Pr	72,434	4,610			50,000	127,044
D.Buxh.dhe Fin.	98,075	14,250				112,325
D.Bujq.Zhv.Rur	68,115	10,500		50,000		128,615
D.Arsim	6,148,782	537,840	70,100	100,000	561,299	7,418,021
D.Shëndetësia	1,288,247	340,590	44,400	76,347	350,000	2,099,584
Shërb.Sociale	94,355	17,180	5,000			116,535
D.Urban.Pl.Haps.	53,385	17,450			41,000	111,835
D.Kultur,R,Sport	72,639	47,420		130,000	450,000	700,059
D.Shërb.Publike	182,294	207,550	52,000	10,000	277,500	729,344
D.Inspeksion	58,954	36,100				95,054
Z.Kryetarit	128,479	42,200		20,000		190,679
Z.Kuvendi	109,465	24,550				134,015
Z.Komunitete	8,323	1,640				9,963
D.Zhvilli. Ekono.	45,277	7,500				52,777
D.Infrastrukturë	49,505	17,450			3,100,000	3,166,955
Gjithsej:	8,753,059	1,458,950	173,000	391,347	4,880,799	15,657,155

Tabela 7: Kërkesat buxhetore për vitin 2021

Programet	Paga dhe Mëq.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Ko- munale	Subvenci- one	Sh.Kapital- e	Gjithsej
D.Administratë	276,102	132,120	1,500	5,000	50,000	464,722
D.Gjeod. Kad	72,796	4,610			50,000	127,406
D.Buxh.dhe Fin	98,565	14,050				112,615
D.Buj.Zhv.Rur	68,456	9,900		50,000		128,356
D.Arsim	6,180,531	537,840	70,100	100,000	600,000	7,488,471
D.Shëndetësi	1,294,688	340,090	44,400	76,347	470,082	2,225,607
Shërb.Sociale	94,827	17,140	7,900			119,867
D.Urban.Pl.Ha	53,652	17,450			41,000	112,102
D.Kult,R,Sport	73,002	34,945		150,000	700,000	957,947
D.Shërb.Publik	183,205	207,550	52,000	10,000	257,500	710,255
D.Inspeksion	59,249	36,700				95,949
Z.Kryetarit	129,121	42,200		20,000		191,321
Z.Kuvendi	110,012	24,550				134,562
